



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____/2018
Dt. 23.02.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 nenin 17 shkronja e të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 18 shkronja e të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe në nenin 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit 04/L-114 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.02.2018, pas diskutimeve lidhur me pikën e 3-të të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, e miratoi këtë:

V e n d i m

1. Formohet Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, në Komunën e Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Aferdita Lama ---- Përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës
2. Z. Flamur Fetahaj -----Përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
3. Z. Shpat Nivokazi ----- Përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
4. Z. Idriz Daci -----Përfaqësues nga Shoqëria Civile
5. Znj. Drita Buza -----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
6. Z. Zef Komoni -----Përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
7. Znj. Mimoza Shala-----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Anëtarëve të Komisionit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
- Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala